

MARRËDHËNIET MIDIS KOSOVËS DHE SHQIPËRISË NË VITIN 1974

Sipas një raport-programi sekret të Mr. Ukshin Hotit

Filozofi, politologu, veprimtari, autori i disa shkrimeve me karakter filozofik e politik, i njohur edhe për librin e tij “Filozofia politike e çështje shqiptare”, i shkolluar në Prishtinë, Zagreb e Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ligjërues në Universitetin e Prishtinës, Mr. Ukshin Hoti,¹ në vitet ‘70 të shekullit të kaluar i kishte bërë vend vetes edhe në, siç quhej asokohe, Sekretariatit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme. Për më tepër, nga të dhënat e dokumentacionit të këtij sekretariati, rezulton se Mr. Ukshin Hoti, së bashku me Prof. Dr. Zejnullah Grudën², përbënin dy shtylla kryesore në udhëheqjen e këtij shërbimi.

Sigurisht, duke qenë në pozita me rëndësi në këtë sekretariat, Mr. Ukshin Hotit përgatiste dhe raporte e programe specifike që lidheshin me natyrën e punës së këtij sekretariati.

Kështu, në mesin e shumë dokumenteve që ruhen në Arkivin e Kosovës, në fondin e Sekretariatit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme,

1 **Ukshin Hotit (1942-1999)**. Lindi në Krushë të Madhe, komuna e Rahovecit, ku kreu shkollën fillore. Normalen e kreu në Prizren e Prishtinë. Studimet për shkencën politike i kreu në Zagreb dhe ato pasuniversitare në Beograd. Nga viti 1972 deri më 1978, ishte sekretar për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në Këshillin Ekzekutiv të KSA-së së Kosovës. Pas dorëheqjes nga ky post, u specializua në universitetet si: Harvard, Çikago, Kembrixh dhe Uashington. Shkroi veprat “Lufta e ftohtë dhe detanti” më 1975 dhe “Filozofia politike e çështje shqiptare” më 1995. Nga vitet ‘70 deri më 1981, kur u burgos nga pushteti i atëhershëm, mbajti disa poste politike e arsimore. Lirohet nga burgu më 1985 dhe më 1993 burgoset për të dytën herë. Më 16 maj 1999, një ditë para se ta përfundonte vuajtjen e dënimit, nxirret jashtë objektivit të burgut dhe, nga ajo kohë, nuk dihet asgjë për të. Shih: “*Fjalori Enciklopedik i Kosovës I*”, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 631-632.

2 **Zejnullah Gruda (1936)**. Jurist, profesor universitar, diplomat. Lindi në Pejë, ku edhe mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. U diplomua në Fakultetin Juridik, në Universitetin e Sarajevës, ndërsa studimet pasuniversitare, magistraturën dhe doktoraturën i kreu në Universitetin e Beogradit. Nga viti 1962, ka ligjëruar në Universitetin e Prishtinës dhe të rajonit. Ishte ambasador i ish-Jugosllavisë në Panama (1975-1978) dhe sekretar për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në Këshillin Ekzekutiv të KSA-së së Kosovës (1979-1981). Është autor i disa librave. Shih: “*Fjalori Enciklopedik i Kosovës I*”, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 527.

gjenden edhe shumë dokumente që mbajnë firmën e Mr. Ukshin Hotit, aq sa ky fond, jo zyrtarisht nga hulumtuesit dhe punonjësit e Arkivit të Kosovës, quhet edhe si “Fondi i Ukshin Hotit”.

Në mesin e kësaj shumësie dokumentesh të hulumtuara nga ky fond, vëmendjen tonë posaçërisht e ka tërhequr një raport-program i përgatitur nga Mr. Ukshin Hoti, i cili më 20 nëntor 1974 i qe dërguar Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, me titullin: *“Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe të RP të Shqipërisë-Pozita e KSA të Kosovës dhe detyrat e saj”*.³

Ky raport-program mban mbishkrimin *“Tepër rezervat”* dhe porositet që të shfrytëzohet vetëm për përdorim personal. Raporti është i shkruar në dy gjuhë, serbisht⁴ dhe shqip⁵, është i shkruar me makinë shkrimi dhe vjen qartë, i lexueshëm dhe korrekt.

Gjatë prezantimit të këtij dokument-raporti në këtë vështrim tonin, jemi mbështetur në versionin e tij në gjuhën shqipe, pa bërë ndonjë shënim plotësues dhe pa hequr asgjë, gjithmonë duke e krahasuar edhe me versionin në gjuhën serbe.

Tri janë arsyet kryesore, përse e kemi parë të udhës që lexuesit t’ia sjellim këtë punim:

- E para,** sepse ky raport-program në kohën kur është shkruar, ka qenë “Tepër i rezervuar” dhe është hartuar nga një personalitet dhe njohës i mirë i filozofisë politike shqiptare.
- E dyta,** sepse, për aq sa jemi në dijeni, ky raport-program nuk është botuar në tërësinë e tij deri më sot.
- E treta,** sepse lexuesi mund ta shohë se cili ka qenë qëndrimi dhe vizioni i Ukshin Hotit, për marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë në ato vite, si i ka parë ai këto marrëdhënie dhe çfarë propozimesh e sugjerimesh ka dhënë në këtë drejtim.

Por, para se ta paraqesim këtë raport-program, e shohim të udhës të theksojmë edhe se ky dokument nis me një vështrim për marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi, që nga viti 1968, pastaj me ngjarjet që kishin ndodhur

3 Arkivi i Kosovës, (më tej: AK), Fondi (më tej: F), Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme (më tej: SKMBJ), Viti (më tej: V), 1979-1988, Kutia (më tej: K), 3, Nr. i lëndës 36.

4 AK, F. SKMBJ, V. 1985-1991, K. 2, Nr. i lëndës 56-101. *Odnosi Ismdju SFR Jugoslavije i NR Albanije-Položaj SAP Kosova i njeni zadaci-Glavne teze.*

5 AK, F. SKMBJ, V. 1979-1988, K. 3, Nr. i lëndës 36. *“Marrëdhëniet midis RSF të Jugosllavisë dhe të RP të Shqipërisë-Pozita e KSA të Kosovës dhe detyrat e saj”.*

në Çekosllovakia, kur Rusia e kishte pushtuar atë, dhe se sipas hartuesit të raportit, Mr. Ukshin Hotit, këto marrëdhënie deri në vitin 1974 “*karakterizohen me linjën e zhvillimit të përgjithshëm*”, por që ende ekzistojnë kundërthënie. Në dokument flitet edhe për marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, të cilat vendosen më 1970, pas fjalimeve të Enver Hoxhës në Tropojë dhe Titos në Ulqin, të mbajtura më 1969.

Dokumenti po ashtu flet edhe për marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Sipas autorit të këtij dokumenti:

“Orientimi kah forcimi i bashkëpunimit midis dy vendeve tona është e theksuar përsëri në Kongresin X të LKJ, e pastaj në fjalimin e Enver Hoxhës, Sekretariatit të Parë të Partisë së Punës së Shqipërisë, në fillimin e tetorit të këtij viti, gjatë kohës së takimit të tij me zgjedhësit e vet, si dhe në fjalimin e Mehmet Shehut në tetor të këtij viti para Kuvendit, me rastin e formimit të qeverisë së re. Sa i përket RSFJ-së në fjalimin e shokut Tito, në Kongresin e dhjetë dhe në Rezolutën e Kongresit, me titull “LKJ në luftën për paqe, për bashkëpunimin ndërkombëtar të barabartë dhe për socializmin”. Aty theksohet se LKJ-ja konsideron zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore “me interes vital për vendin tonë dhe se kjo përfaqëson një nga komponentët themelorë të politikës së jashtme të RSFJ-së”.

Mund të thuhet se ky raport-program është i përbërë nga dy shtylla:

Shtylla e parë është se paraqiten marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë, me theks të veçantë Kosovën, ku prezantohet mbarëvajtja e këtyre marrëdhënieve në aspektin ekonomik, kulturor e arsimor.

Por është për t’u theksuar se përpiluesi i dokumentit, aspektit kulturor të Shqipërisë i bën edhe këtë vështrim:

“...manifestimeve kulturele i kushtohet kujdes i madh. Në të vërtetë, për ta, këto manifestime kanë rol të dyfishtë: a – rolin mobilizues dhe b – rolin afirmues. Duke pasur parasysh karakterin relativisht të mbyllur të shoqërisë shqiptare në luftën e tyre të pandërprerë kundër të ashtuquajturave ndihmave të huaja, në Republikën Popullore (RP) të Shqipërisë kjo formë e jetës po bëhet zëvendësim i një jete të llojllojshme kulturele dhe masat në këtë mënyrë po mobilizohen. RP e Shqipërisë bën shumë përpjekje që t’i afirmojë vlerat vetjake kulturele, duke u munduar të mbajë autenticitetin dhe më atë të afirmohet në botë. Duke aplikuar

mësimet e marksizëm-leninizimit, si pasojë edhe ato në kulturë, bëhen përpjekjet që vlerat tradicionale të inkorporohet në vlerat moderne por të vërteta kulturele, sepse modernizimi, nëse nuk është i bazuar në traditë autentike, thuhet në Shqipëri, po bëhet sterilitet e jo ndërrim kultural. Ata këtu shohin ndryshimin midis politikës kulturele dhe politikës së këtillë në vendet kapitaliste dhe “revizioniste” dhe këtu bazohen kritikën e tyre të ashpra kundër ndikimit të huaj. Mirëpo, kultura tradicionale, kurrë nuk mund të jetojë veç nga rrjedhat kryesore të jetës së civilizuar, prandaj RP e Shqipërisë dëshiron që në këtë pikëpamje të hapet, por në mënyrë selektive dhe graduale. Ajo nuk dëshiron t'i shtyjë vlerat e veta kulturele me vërshimet e kulturave tjera”.

Shtylla e dytë ka të bëjë me sugjerimet që dokumentshkruesi i ofron për mbarëvajtje sa më të mirë të marrëdhënieve mes Shqipërisë e Kosovës, ku, mes të tjerave, sugjeron:

“Në LK dhe në organizatat e tjera shoqëroro-politike të bëhet më intensiv aktiviteti ideo-politik me interpretimin dhe në kuptimin esencial të disa momenteve, në bashkëpunimin jugosllavo-shqiptar. Në planin politik, si dhe në planin shkencor, arsimor e kultural është e domosdoshme që të vazhdojnë përpjekjet e punës së organizuar me këtë bashkëpunim. Propozohet që në këtë vështrim, për vëllimin e rritur të bashkëpunimit në RP të Shqipërisë dhe bazën e perspektivës në këtë bashkëpunim, të merren masat përkatëse dhe në nivel federativ për forcimin e shërbimit në kuadër të SFPJ-së për përcjelljen e RP-së së Shqipërisë dhe të ambasadës së Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ) në Tiranë. Përpjekjet në drejtim të koordinimit të punës në organet federative duhet të vazhdojnë gjithnjë e më tepër. Për zgjerimin dhe përfshirjen më efikase të krahinës sonë në këtë bashkëpunim, në planin ekonomik, është e domosdoshme që në mënyrë më konkrete dhe me afate, të fillojë realizimi i detyrimeve të përcaktuara, që të mos injorohen as kërkesat më të vogla dhe të mos bëhen shantazhe dhe nënçmime, si dhe kushtëzime”.

Pa dashur të thellohem në analiza të përmbajtjes së këtij dokumenti, po e prezantojmë atë në tërësinë e tij, me qëllim që lexuesi ta japë vetë mendimin e tij.

“Krahina Socialiste Autonome e Kosovës (KSAK) – Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSAK – Sekretariati për Marrëdhënie me Botën e Jashtme.

Nr. 27-54/74. Prishtinë, 20.XI.1974

Bashkangjitur me aktin, po dorëzojmë materialin mbi marrëdhëniet e RP-së së Shqipërisë, të dedikuara Kryesisë së Krahinës, me lutje që t'i jepni sugjerimet dhe vërejtjet tuaja paraprake, në frymën e marrëveshjes së përbashkët mbi përgatitjet e këtij materiali. Për shkak të urgjencës së shqyrtimit të tij nga ana e kryesisë, luteni që të gjeni kohë për konsultim të përbashkët gjatë ditës së nesërme, me kohën që do ta caktoni vetë.

Sekretari Mr. Ukshin Hoti”⁶

Marrëdhëniet midis RSF-së së Jugosllavisë dhe të RP-së së Shqipërisë

Pozita e KSA-së së Kosovës dhe detyrat e saj

Marrëdhëniet midis RSFJ-së dhe RPSH-së në 6 vitet e fundit (prej ngjarjeve në Çekosllovakia, më 1968) karakterizohen me linjën e zhvillimit të përgjithshëm. Ende ka kundërthënie në marrëdhëniet midis dy vendeve fqinje, por më tepër është e pranishme dëshira e të dy palëve që këto të zhvillohen në baza, në të mirë të të dy anëve. Këto dëshira në mënyrë të qartë dhe publike, janë shprehur menjëherë pas ngjarjeve në Çekosllovakia, në fjalimin e Enver Hoxhës, më 1969, në Tropojë. Po në këtë vit, kryetari Tito në Ulqin shprehu interesimin tonë për zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore me RP-në e Shqipërisë. Si pasojë e kësaj, më 1970, Jugosllavia e Shqipëria formuan përfaqësitë e veta diplomatike në Beograd, respektivisht në Tiranë, në rangun e ambasadave dhe më 1971, shkëmbyen ambasadorët e vet. Gjatë kësaj periudhe, Republika e Shqipërisë filloi gradualisht të hapet ndaj vendeve të tjera, kështu që nuk është më shtet i izoluar që mban marrëdhëniet vetëm me një numër të vogël shtetesh. Marrëdhëniet e saj me RP-në e Kinës janë vlerësuar nga ana e tyre si të përzemërta e miqësore, internacionaliste e të tjera. RP e Shqipërisë nuk e imiton politikën e RP-së së Kinës, siç theksohet shpeshherë në Perëndim. Megjithëse nganjëherë në mënyrë të tepërt theksojnë disa aspekte të politikës së tyre – e kjo duhet të merret me rezervë. Objektivisht, politika e tyre e jashtme është rezultat i qenies së tërësishme politike të Shqipërisë dhe marrëdhëniet e saj me botën janë specifike për aq sa është specifike qenia politike shtetërore e Shqipërisë në relacionin me madhësinë e saj, me pozitën gjeo-strategjike, me të cilat po zhvillohet ky proces. RP e Shqipërisë ka krijuar marrëdhënie diplomatike

6 AK, F. SKMBJ, V. 1985-1991, K. 2, Nr. i lëndës 56-101.

me 67 vende të Azisë, të Afrikës dhe të Evropës. Nuk ka marrëdhënie diplomatike e politike apo ekonomike me Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Mban marrëdhënie politike-ekonomike me Italinë, pastaj me Francën, me shtetet nordike dhe me shtetet e Beneluksit, me Turqinë e deri diku me Greqinë. Kryesisht lidhjet e saj të politikës së jashtme në Evropë janë të orientuara kah e ashtuquajtura zona II industriale. Nga vendet socialiste të Lindjes mban lidhje me Rumaninë, sidomos në planin kultural, kurse me Republikën Demokratike Gjermane dhe Çekosllovinë në planin ekonomik. Orientimi kah forcimi i bashkëpunimit midis dy vendeve tona është e theksuar përsëri në Kongresin X të LKJ-së, e pastaj në fjalimin e Enver Hoxhës, Sekretariatit të Parë të Partisë së Punës së Shqipërisë, në fillimin e tetorit të këtij viti, gjatë kohës së takimit të tij me zgjedhësit e vet, si dhe në fjalimin e Mehmet Shehut në tetor të këtij viti para Kuvendit, me rastin e formimit të qeverisë së re. Sa i përket RSFJ-së në fjalimin e shokut Tito, në Kongresin e dhjetë dhe në Rezolutën e Kongresit me titull “LKJ në luftën për paqe, për bashkëpunimin ndërkombëtar të barabartë dhe për socializmin”, theksohet se LKJ-ja konsideron zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore “me interes vital për vendin tonë dhe se kjo përfaqëson një nga komponentët themelorë të politikës së jashtme të RSFJ-së”. U theksua se politika e mosinkuadrimin e RSFJ-së nuk është e ndarë nga esenca klasore. Në rezolutën e përmendur thuhet se Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, në mënyrë konsekuente, lufton për përmbajtjen klasore-revolucionare të politikës së Jugosllavisë dhe se “anëtarët e saj në aktivitetin ndërkombëtar” udhëhiqen me shkencën marksiste, me mendimin dhe veprën e shokut Tito në luftën për pavarësi e paqe, për marrëdhënie të barabarta e demokratike ndërkombëtare, për progresin shoqëror, për tejkalimin e jazit midis të zhvilluarve dhe të pazhvilluarve, për lirin e punës e të personalitetit njerëzor – për socializmin”. Praktika e politikës së jashtme të RSFJ-së dhe marrëdhëniet e gjera që mban me pjesën më të madhe të botës, janë vërtetimi më i mirë i një qëndrimi të tillë. Gjatë këtij viti, Shqipëria ka sjellë disa elemente qenësore të reja lidhur me RSFJ-në, të cilat hapin mundësi më të madhe për zgjerimin e bashkëpunimit. Në fjalimin e 4 tetorit të këtij viti, Enver Hoxha, për herë të parë pas vitit 1948, në kontekstin e sulmit të imperializmit amerikan dhe sovjetik “social-imperializmin”, ka folur pozitivisht për shokun Tito. Duke theksuar dëshirën për zhvillimin e marrëdhënieve me ne, ka theksuar aftësinë e marrëveshjes midis popujve tanë në të kaluarën, gatishmërinë e tyre që të gjejnë fjalën e përbashkët në të ardhmen, si dhe gatishmërinë e tyre për luftën e përbashkët kundër armikut

të përbashkët. Në fjalimin e vet ka theksuar frymën liridashëse të popujve tanë, duke thënë se “populli shqiptar, jugosllav dhe grek nuk kanë shpirt skllavi” dhe se këtë e kanë “treguar gjatë historisë së vet shekullore”. Ai thekson gatishmërinë e Shqipërisë, se nga territori i saj nuk do të lejohet sulmin në Jugosllavi. Njëkohësisht ka theksuar pavarësinë e Jugosllavisë, të Shqipërisë dhe të Greqisë, për të cilat thotë se jo “vetëm që jetojnë pa Traktatin e Varshavës e të Paktit NATO, por jetojnë të lira dhe të pavarura”. Mehmet Shehu, më 30 tetor, konkretizon fjalimin e Enverit. Ky i rendit vendet me të cilat Shqipëria mban marrëdhënie, duke thënë se Shqipëria mban lidhje e bashkëpunim miqësor me vendet socialiste, duke pasur parasysh dhe duke menduar për Republikën Demokratike të Koresë, të dy Vietnamët, kurse Republikën Popullore të Kinës e ka ndarë veçanërisht si vend me të cilin mbajnë lidhje miqësore të ndihmës dhe bashkëpunimit internacjonalist. Ne na ka vënë në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare të RP-së së Shqipërisë. Thotë se me ne mbajnë “marrëdhënie të bashkëpunimit normal ndërshtetëror”, në bazë të dobisë së të dy palëve dhe të mospërzjerjes në punët e brendshme. Pra, ka përmendur princippet mbi të cilat bazohet ky bashkëpunim. Njëkohësisht, thekson gatishmërinë që këto marrëdhënie të zgjerohen përkitazi me çështjen me interes të përbashkët. Ajo që është me rëndësi në këtë fjalim, ka të bëjë me faktin se Jugosllavia është distancuar nga “rrethi kapitalist-revizionist” i RP-së së Shqipërisë. Megjithëse flasin për revizionizmin në përgjithësi, në mënyrë të qartë bëjnë me dije se nuk konsiderojnë që u kanoset ndonjë rrezik nga ana jonë. Nga ana jonë, në Sekretariatit e Punëve të Jashtme është ftuar ambasadori shqiptar në Beograd dhe i është shprehur reagimi ynë pozitiv, lidhur me pjesën e fjalimit që kishte të bënte me ne. Shoku M. Miniq, nënkryetar i KEF-it dhe sekretar federativ i punëve të jashtme, i karakterizoi pozitivisht marrëdhëniet me RP-në e Shqipërisë, duke thënë se këto po zhvillohen gjithnjë e më tej. Thekson interesimin tonë dhe gatishmërinë e përhershme për zhvillimin e bashkëpunimit me RP-në e Shqipërisë. “Zëri i Popullit” në tërësi e transmeton këtë pjesë të fjalimit të shokut M. Miniq, përveç fjalisë që ka të bëjë me atë se, edhe më përpara, kemi qenë të interesuar për zhvillimin e këtyre marrëdhënieve dhe asaj me të cilën shprehet shpresa për nënshkrimin e programit të bashkëpunimit kultural me RP-në e Shqipërisë. Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare, në të vërtetë, bazohen edhe në disa elemente të natyrës afatgjate, siç janë pozita gjeo-politike dhe strategjike e vendeve tona, kushtet e ngjashme të zhvillimit të luftërave nacionalçlirimtare dhe të luftës revolucionare, qëllimet qenësore dhe strategjike të zhvillimit ekonomik dhe politik të të dy vendeve dhe faktori i popullsisë shqiptare në Jugosllavi.

Pozita gjeo-politike është e lidhur ngushtë me lëvizjet në skenën ndërkombëtare. Superfuqitë nuk kanë hequr dorë nga politika e vet e forcës, gjë që e vërteton sjellja e tyre konkrete në botë, sidomos presioni ndaj nesh dhe vendeve në zhvillim, lidhur me luftën për ndryshimin e marrëdhënieve ndërkombëtare ekonomike dhe për demokratizimin e politikës ndërkombëtare. Nga ana tjetër, kriza energjetike që prej vitit të kaluar ka përfshirë botën, ka sjellë një varg elementesh të reja në mbarë marrëdhëniet ndërkombëtare, të cilat po reflektohen edhe në këtë pjesë të Ballkanit. Po bëhet një presion i madh ndaj prodhuesve të naftës, që mos t'i rrisin çmimet. Këto nganjëherë kërcënohen edhe me përdorimin direkt të forcës. Por, më së tepërmi, në mënyrë indirekte shkaktojnë krizat si në Qipro dhe mbajnë gjendjen as luftë, as paqe, si p.sh., në Lindjen e Afërme dhe, më në fund, bëjnë presion në ne, që të ndikojnë te prodhuesit arabë, që t'i zvogëlojnë çmimet e naftës. Janë përmendur vetëm disa elemente të cilat në planin global determinojnë marrëdhëniet midis RSFJ-së dhe të RP-së së Shqipërisë. Karakteristikë e përbashkët e kësaj është se ekziston atmosfera pozitive për përmirësimin e zgjerimin edhe më të madh të këtij bashkëpunimi dhe sigurojnë shanse pozitive për inkuadrimit më të madh të Krahinës në këto marrëdhënie. E dyta, këto determinante bëjnë të konkludojmë se kemi të bëjmë me orientimin afatgjatë, lidhur me përmirësimin e marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, e jo me dëshirat momentale që mund të ndryshohen lehtë, për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm që mund të paraqiten në të ardhshmen.

I

Në planin e përgjithshëm të orientimit të Jugosllavisë në pikëpamje të politikës së jashtme, pozita e KSA-së së Kosovës është bërë më e rëndësishme, krahas me zhvillimin e procesit të shoqërizimit të politikës së jashtme, me rolin e LKJ-së, si fuqi orientuese e shoqërisë, dhe me aprovimin e amendamenteve kushtetuese, sidomos me nxjerrjen e Kushtetutës federative e të kushtetutave të republikave e të krahinave. Me zgjidhjet kushtetuese, politika e jashtme edhe më tej, ka mbetur çështje unike e Federatës, por ka ndryshuar mekanizimi i vendosjes që tani kujdeset për pozitën konkrete të republikave e të krahinave. Këto kanë fituar një tretman (trajtim) më ndryshe, si në krijimin, ashtu edhe në zbatimin e politikës së jashtme të RSFJ-së. Janë bërë përpjekje të konsiderueshme, që KSA e Kosovës, edhe në kuptimin organizativ, të jetë në nivelin e detyrave të veta, në aspektin e politikës së jashtme. Disa bartës e subjekte ekzistuese të këtij aktiviteti edhe më tepër kanë zgjeruar këtë aktivitet, disa të tjerë janë aftësuar që të merren

edhe me këtë aspekt të aktivitetit të vet dhe janë krijuar disa subjekte të reja që tani po merren me aspektet e ndryshme të kësaj veprimtarie. Procesi i aftësimit organizativ nuk është zhvilluar sipas hapave me vëllimin e shtuar të bashkëpunimit të Krahinës me botën e jashtme, por konkretisht, lidhur me RP-në e Shqipërisë, Krahina po bëhet një faktor gjithnjë e më i rëndësishëm i bashkëpunimit të mirë fqinjësor të Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Është krijuar atmosfera e përshtatshme dhe janë hapur shanse të reja për kontributin e saj pozitiv, lidhur me këtë bashkëpunim. Në planin ekonomik, përvoja e gjertanishme tregon se shkëmbimi i mallrave, si formë kryesore e bashkëpunimit ekonomik, ishte i vetmi element konstant në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare. Pas vitit 1969, kjo përherë po shtohet. Shqipëria është lidhur me Malin e Zi nëpërmes të elektrosistemit. Gjatë këtij viti, është nënshkruar protokollin mbi shkëmbimin e mallrave në shumën e paraparë prej rreth 50 milion dollarësh të US-së, që është me rëndësi edhe për RP-në e Shqipërisë, edhe për ne. Është arritur marrëveshja që protokollin i ardhshëm të nënshkruhet në nivel të ministrave të Punëve të Tregtisë së Jashtme. Disa parallogari flasin për shifrën optimiste prej 350 milion dollarësh US të dy drejtimet, edhe për kohën prej pesë vitesh (65-75 milion dollarë US në vit). Është shprehur dëshira e është duke u punuar në këtë, për lidhjen hekurudhore me ne, në drejtim të Malit të Zi e të Maqedonisë. Me ndërtimin e hidrocentralit “Fierza” në drejtim të Kukësit, po vërskohet një lidhje direkte e rëndësishme me Kosovën dhe me RP-në e Shqipërisë, prandaj duhet të merret diçka urgjente për gjetjen e mundësisë së lidhjes hekurudhore, apo të ndonjë lidhjeje tjetër të komunikacionit me RP-në e Shqipërisë. Shqiptarët tanimë e kanë kërkuar dërgimin e tre ekspertëve të vet për panxharsheqerin, për shkëmbimin e përvojave të ne dhe ekzistojnë shpresat se kjo do të jetë formë fillestare e bashkëpunimit teknik dhe se në të ardhmen do të paraqiten edhe disa forma të tjera të bashkëpunimit teknologjik. Tani për tani, megjithëkëtë, nuk duhet pritur diçka më tepër se kjo formë e bashkëpunimit. Këta kryesisht refuzojnë bashkëpunimin e tillë më të gjithë, përveç me RP-në e Kinës. Për ne, bashkëpunimi teknologjik mund të jetë formë e bashkëpunimit në të ardhmen, si mundësi potenciale që mund ta ofrojmë përherë, por jo si mjet që të bëhet ndonjë presion në këtë drejtim. Në planin e shkëmbimit të mallrave, shqiptarët kanë arritur limitin, në krahasim me ne, meqenëse ekonomia është e kufizuar me vëllim fizik të shkëmbimit të mallrave. Në qoftë se veçohet RP e Kinës, RSFJ-ja gjendet midis vendit të dytë dhe të tretë në marrëdhëniet e tregtisë së jashtme me RP-në e Shqipërisë. Vendi ynë në këtë është gati i njëjtë me atë të Çekoslllovakisë. Përkundër rezultateve pozitive, bashkëpunimi ynë ekonomik me RP-në e Shqipërisë nuk është organizuar sa duhet. Nevojat e tyre të tregut, si dhe mundësia blerëse e tregut global nuk janë studiuar sa duhet, ende ka dobësi që janë karakteristike

për mbarë rretën jugosllave të tregtisë së jashtme (konkurrenca jolojale (e pandershme) në oferta, monopoli mbi prodhimet e caktuara, spekulimet me çmime) dhe nuk i kushtohet kujdes në masë të duhur udhëheqjes së tyre centraliste me ekonominë. Këto dobësi, gjithashtu, i karakterizojnë marrëdhëniet ekonomike të Krahinës sonë me këtë vend, gjë që parashton nevojën që menjëherë të merren masat përkatëse për orientimin e marrëdhënieve ekonomike në drejtimin e dëshiruar dhe për forcimin e strukturës e të formave të shkëmbimit të mallrave nga KSA e Kosovës. Shpeshherë, organizatat tona ekonomike nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur tregut të Shqipërisë. Në planin e zhvillimit ekonomik, Shqipëria ka shënuar rezultat të konsiderueshëm. Ky është shtet agrar-industrial dhe ka për qëllim të bëhet industrial-agrar, por duke u mbështetur në forcat e veta dhe në ndihmën e RP-së së Kinës. Ka ndërtuar degë të tëra industriale, siç është ajo kimike, e tekstilit, industria ekstraktive e të tjera, ka shndërruar rreth 120.000 hektarë në sipërfaqe të punueshme (ish-lugina moçalike e Myzeqesë) dhe 60% të mbarë sipërfaqes së punës ujitet. Janë ndërtuar një varg objektesh të reja të rëndësishme (Hidrocentrali “Mao Ce Dun” dhe “Fierza”, rafineria e naftës prej një milion tonësh, kombinati metalurgjik afër Elbasanit). Ndërkaq, kjo nuk mund të matet me masat tona e as që i plotëson nevojat e popullsisë me artikuj ushqimorë (vetëm në nivelin prej 83%). Shkurtimisht, kjo ka krijuar bazën për zhvillimin e mëtejshëm industrial. Ndërkaq, mënyra e zhvillimit të mëtejshëm, si duket, në Shqipëri ka shtruar në rendin e ditës çështjen e karakterit më të madh, siç është çështja e hapjes së saj më të madhe ndaj botës së jashtme, marrja e kredive të huaja etj. Akumulimi vetjak për shkallën prej 9.5% të shtimit industrial gjithnjë e më tepër parashton kërkesa të reja nga popullsia. Shkurtimisht, pa marrë parasysh orientimin e tanishëm të vendosur të udhëheqjes, që të vazhdohet me rrugën dhe mënyrën e filluar, megjithëkëtë, këtu kemi një nga burimet e dilemave, frikës dhe pakënaqësisë, që ka të bëjë me çështjen “ç’të bëhet më tej?”. Meditimet e këtij lloji në RP-në e Shqipërisë i dënojnë rreptësisht dhe, tani për tani, nuk ka dilemë të pjesa më e madhe e udhëheqësve, lidhur me metodën e zhvillimit të mëtejshëm, ose këto nuk janë nxjerrë në shesh. Ky forcim në planin ekonomik, krijimi i bazës së caktuar të stabilitetit vetjak përfaqëson një nga motivet jo vetëm të hapjes ndaj nesh, por edhe të hapjes në përgjithësi. Në marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare ekonomike shkëmbimi i Kosovës me RP-në e Shqipërisë, në vitin 1973, ka përfshirë vetëm 1,5% të shkëmbimit të Jugosllavisë me RP-në e Shqipërisë. Kjo përqindje ka të bëjë vetëm me mallrat e prodhuara në Kosovë e jo edhe me shkëmbimin e përgjithshëm të tregtisë së jashtme të KSA-së së Kosovës me RP-në e Shqipërisë, që është më i madh se përqindja e përmendur. Shkaqet kryesisht janë të natyrës objektive: lista e mallrave që mund t’ua ofrojnë, nuk koïncidon shumë me nevojat e RP-së së Shqipërisë. Nevojat për prodhimet

industriale i plotëson nga viset e zhvilluara të vendit tonë. Pastaj paraqiten disa shkaqe të tjera, siç është konkurrenca jolojale, mosrespektimi i afateve të dërgesave etj. Në shumë analiza nuk llogaritet nevoja për rrjetën e rrugëve të kalimit të kufirit, gjë që gjithashtu ndikon negativisht në vëllimin e shkëmbimit të mallrave, për shkak të vështirësive rreth transportit. KSA e Kosovës shkëmbimin e vet të mallrave e bën nëpërmes RS-së së Maqedonisë, apo RS-së së Malit të Zi, ku ekzistojnë kalime kufitare. Shkurtimisht, në marrëdhëniet tregtare me RP-në e Shqipërisë ekonomia duhet të ketë kujdes më tepër për politikën, për shkak të interesimit për marrëdhëniet me karakter afatgjatë. Ky fakt shtrun nevojën që të intensifikohet puna ideo-politike me bartësit shoqërorë të bashkëpunimit ekonomik. Aktiviteti duhet orientuar sidomos kah kuptimi esencial i karakterit të marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, kah natyra e sistemit në Shqipëri, me rëndësinë e një bashkëpunimi të organizuar në këtë vend. Nga ana tjetër, për shkak të specificitetit të RP-së së Shqipërisë, duhet vazhduar me përpjekjet tona, që ky vend të trajtohet në mënyrë specifike, në frymën e vendimeve të mëparshme të KEF-së për transportin e disa artikujve në RP-në e Shqipërisë, ose të shqyrtohet mundësia që të trajtohet si vend në zhvillim.

II

Për ndryshim nga bashkëpunimi ekonomik, në bashkëpunimin arsimor-kultural dhe shkencor, Kosova zë një vend të rëndësishëm, nëse jo edhe vendin më të rëndësishëm, në shkëmbimin e përgjithshëm jugosllavo-shqiptar. Nga kjo, një vend me prioritet zë bashkëpunimi midis Universitetit në Prishtinë dhe Universitetit Shtetëror në Tiranë, që ka filluar për shkak të angazhimit të përhershëm të LKJ-së dhe të anëtarëve të LKJ-së e të LK-së të Kosovës, për bashkëpunimin e mirë fqinjësor me fqinjët tanë. Bashkëpunimi i përmendur është iniciuar për shkak të nevojës sonë për kuadro për mësimin në gjuhën shqipe dhe, me këtë, edhe për afirmimin e të gjitha kombeve e kombësive dhe, në rastin konkret, të kombësisë shqiptare që jeton në Kosovë. Bashkëpunimi është treguar i dobishëm dhe, në mënyrë të caktuar, ka kontribuar për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, gjë që është në frymën principeve dhe parimeve të politikës sonë dhe të linjës së LKJ-së dhe të LKK-së. Bashkëpunimi ka filluar të përfitojë një orientim më të qartë me nënshkrimin e protokollit I të bashkëpunimit ndëruniversitar, në vjeshtën e vitit 1970. Prej atëherë, këto nënshkruhen në mënyrë të suksesshme për çdo vit shkollor. Si pasojë e zvarritjes rreth nënshkrimit të programit të bashkëpunimit kulturor midis dy vendeve, edhe për shkak se ka filluar të zhvillohet një stih i shkëmbimit kulturor, me

iniciativën e KEK-ut është ndërprerë kjo dukuri. Nga ana tjetër, Sekretariati i KK-së të LKK-së, në një mbledhje të vet të zgjeruar, në vjeshtën e vitit 1972, ka marrë qëndrimin e vendosur, që shkëmbimi arsimor-kultural të bëhet në mënyrë të organizuar, nëpërmes Sekretariatit për Marrëdhënie me Botën e Jashtme dhe të Sekretariatit Krahinor për Arsim, Shkencë e Kulturë, me pëlqimin paraprak të kuvendeve komunale. Për këtë shkak, prej atëherë, ky bashkëpunim ka filluar të ketë një formë më të organizuar.

III

*Zhvillimi i bashkëpunimit ndëruniversitar dhe atëherë kur marrëdhëniet midis dy vendeve nuk ishin ende krejtësisht të normalizuara, ka pasur rëndësi politike. Nga ky aspekt, kontributi i universitetit në drejtim të forcimit të besimit reciprok nuk është pa rëndësi. Bashkëpunimi midis këtyre dy universiteteve në plan të ngushtë profesional-shkencor dhe arsimor, nëpërmes **a)** shkëmbimit të kuadrove për specializimin, perfeksionimin dhe përgatitjen e tezave të magistraturës e të disertacioneve të doktorantit; **b)** shkëmbimin e ligjëruesve të rregullt; **c)** shkëmbimin e ligjëruesve për mbajtjen e kurseve të veçanta të shkurtra në të dy universitetet; **d)** shkëmbimin e të ashtuquajturave ekspedita shkencore për linguistë, folkloristë, etnografë, historianë, arkeologë etj., nga të dy vendet. Pika b), d.m.th., shkëmbimi i ligjëruesve të rregullt, ka të bëjë me ardhjen e ligjëruesve të rregullt nga Universiteti i Tiranës në Universitetin e Prishtinës dhe me mbajtjen e një numri më të madh të njëjësive mësimore, sipas planit dhe programit të Universitetit në Prishtinë. Ligjëruesit tanë nuk mbajnë ligjërata të rregullta në universitet, sipas planeve dhe programeve të tyre, por ligjëratat e tyre janë të vizituara mjaft mirë. Për mungesën e shkëmbimit të ligjëruesve të rregullt, po bëhet përpjekje që të kompensohet në lëmët e tjera, ku kemi të bëjmë me bashkëpunimin e barabartë. Në planin global, bashkëpunimi katërvjeçar midis këtyre dy institucioneve të larta shkollore e shkencore, ka mundësuar mbajtjen e ligjëratave të lëndëve në gjuhën shqipe për të cilat nuk ka qenë e mundur të sigurohet kuadri adekuat. Vlerësimet e vetë Universitetit në Prishtinë tregojnë se shkëmbimi i kuadrove për specializim dhe perfeksionim është treguar si normë e dobishme e bashkëpunimit dhe mënyrë efikase për përgatitjen dhe ngritjen e kuadrove tona nga ana pedagogjike-shkencore. Ishte me rëndësi dhe bashkëpunimi në planin e hulumtimeve shkencore, sidomos ajo që ka të bëjë me përpilimin e fjalorëve terminologjikë, juridikë dhe ekonomikë.*

Dobitë e të dy anëve nga ky bashkëpunim janë të shumta, si në planin e ngushtë shkencor-mësimor, në planin e shkëmbimit të përvojave mbi metodat e hulumtimeve shkencore, tendencat e rritjes së vëllimit, por edhe për thellimin e

lëmive të caktuara të veprimtarisë shkencore-hulumtuese, pasurimin e praktikës dhe teorisë së hulumtimit shkencor etj., ashtu edhe në planin shkencor-teorik dhe politik. Siç u tha më parë, bashkëpunimi dinamik i këtyre dy universiteteve jo vetëm që kontribuon për forcimin e besimit ndaj nesh, por sjell edhe dimensione më të gjera në mendimin shkencor-teorik tek inteligjenca, te disa qarqe të caktuara të punëtorëve të kulturës dhe një jetën politike. Sa më tepër që kontribuon edhe për zgjedhjen e çështjeve konkrete teknike, kjo sjell njoftime të reja nga lëmët e caktuara të punës konkrete në procesin e krijimit të veprës shkencore e të tjera. Analiza e bashkëpunimit katërvjeçar midis Universitetit në Prishtinë dhe Universitetit Shtetëror në Tiranë tregon se ky bashkëpunim, para se gjithash, gjithnjë e më tepër po zhvillohet në mënyrë të organizuar etj., se gjithnjë e më tepër po fiton një karakter më tepër të fazës së bashkëpunimit shkencor-arsimor. Absolutisht, shkëmbimi i ligjëruesve është rritur, por edhe zvogëlimi relativ i këtij bashkëpunimi po shihet, në qoftë se kjo lidhet me zhvillimin dinamik të universitetit tonë, si nga aspekti i vëllimit fizik (hapja e fakulteteve të reja dhe sjellja e një numri të madh të lëndëve të reja mësimore), ashtu dhe në pikëpamje të kualitetit. Objektivisht, bashkëpunimi midis këtyre dy universiteteve gjithnjë e më tepër po aplikon elemente të bashkëpunimit shkencor në planin shkencor-hulumtues dhe gjithnjë e më pak po bëhet bashkëpunim me karakter arsimor-shkencor. Universiteti në Prishtinë po përpiqet të realizojë aplikimin e këtij parimi në kuptim të transformimit të vetë karakterit të këtij bashkëpunimi, në mënyrë që të ketë më tepër bashkëpunim me karakter shkencor. Universiteti po përpiqet që këtë parim ta shndërrojë në kriter për caktimin e vetë kualitetit të tij.

Bashkëpunimi arsimor-shkencor që e aprovon Universiteti në Prishtinë dhe ligjëruesit u përmbahen programeve të tilla dhe temave të caktuara. Me rastin e nënshkrimit të protokolleve vjetore të bashkëpunimit, kujdes të veçantë i kushtohet aplikimit të parimit të reciprocitetit, në kuadër të nevojave të njërës ose tjetrës universitet dhe në kuadër të mundësive të tyre reale. Me fjalë të tjera, megjithëse nuk është mundur që konkretisht të arrihet i ashtuquajti reciprocitet absolut, ai është inkorporuar si qëllim i shkëmbimit konkret të ligjëruesve për të cilën pretendohet për t'u siguruar forma e barabartë e bashkëpunimit mes tyre. Gjatë zhvillimit të shkëmbimit konkret të ligjëruesve nga secila prej katër formave të përmendura, Universiteti në Prishtinë përpiqet që në Universitetin e Tiranës (UT) të dërgohen ligjërues me kualitete të larta të kombit shqiptar, serb malazez etj., jo vetëm nga radhët e arsimtarëve të tyre të rregullt, por edhe nga radhët e ligjëruesve nga qendrat e tjera universitare që ndodhen në marrëdhënie të rregullta ose me honorar. Në anën tjetër, ligjëruesve nga UT u organizohen vizita në qendrat e tjera universitare të Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, bashkëpunimi

fiton një dimension më të gjerë dhe shërben për të fituar njohuri mbi arritjet shkencore e të tjera në të dy vendet.

Bashkëpunimi i Universitetit në Prishtinë me Universitetin në Tiranë, gjer me tani, ka dhënë edhe një seri rezultatesh të tjera pozitive në lëmën e shkencës e kulturës dhe ajo, shkurtimisht, nëpërmes përpjekjeve të përbashkëta të punëtorëve të hulumtimit të të dy universiteteve, që në një anë kontribuon në pasurimin e të arriturave shkencore arsimore të popullit shqiptar në tërësi, dhe mandej, nëpërmes përpjekjeve për unifikimin e gjuhëve, kërkimeve nga lëma e shkencave të linguistikës, trashëgimive kulturore, kërkimeve etnologjike, etnografike dhe arkeologjike në krijimin dhe afirmimin e kulturës dhe historisë antike nacionale, gjë që në këtë bëhen më të begatshme dhe ma me përmbajtje. Në të vërtetë, më këto përpjekje që janë bërë për begatshmërinë e të arriturave shkencore dhe kulture, përmbahet njëra nga normat më të rëndësishme të realizimit të të drejtave vetëqeverisëse të Krahinës dhe vërtetimi konkret i barazisë së kombeve dhe të kombësive të ne. Te bashkëpunimi ndëruniversitar, duhet bërë përpjekje më e madhe në drejtim të eliminimit të dukurive që rezultojnë nga praktika konkrete e realizimit të protokollit të bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve të shkollimit të lartë dhe shkencor. Askush nuk mund, në mënyrë jo të organizuar dhe privatisht, të angazhohet për realizimin e protokollit të bashkëpunimit midis Universitetit në Prishtinë dhe Universitetit në Tiranë dhe nuk mund të lejojë shndërrimin e kësaj forme të rëndësishme të bashkëpunimit në atë jo të dobishme dhe turizëm privat shkencor. Disa dukuri janë rezultat i koordinimit të pamjaftueshëm shkencor midis institucioneve të ndryshme shkencore etj. Megjithëse Universiteti në Prishtinë konsultohet rregullisht me organet kompetente, përpunimi më i mirë i sistemit të informimit, të koordinimit reciprok të institucioneve vetëqeverisëse do të ndikojë jo vetëm në zvogëlimin e vëllimit të dukurive të panevojshme, por ato do të japin pasqyrën e situatës së shoqërisë sonë në tërësi. Përpjekjet në këtë vështrim janë duke u bërë përherë dhe ato edhe në të ardhmen do të bëhen.

IV

Përveç bashkëpunimit të Universitetit në Prishtinë me UT, me këtë universitet bashkëpunon edhe Universiteti në Shkup, i cili ka gjithashtu protokollin e bashkëpunimit me RP-në e Shqipërisë dhe zhvillohen edhe forma të tjera për bashkëpunim arsimor shkencor dhe kultural. Njëra nga format më të afërme të bashkëpunimit shkencor është shkëmbimi i dokumentacionit shkencor dhe arsimor midis bibliotekës popullore universitare në Prishtinë, Arkivit të Kosovës, Entit për mjete dhe tekste

shkollore, “Rilindjes” – Edicioni për botimin e librave shkollore dhe institucioneve të tjera me partnerët përkatës në RP-në e Shqipërisë. Gjer tani, nuk ka probleme esenciale në marrëdhëniet e këtyre institucioneve, përveç një orientimit tonë të brendshëm, që duhet t’i precizojë dhe definojë punët me të cilat këto institucione mund të merren, sa i përket bashkëpunimit të tyre me botën e jashtme. Këto dhe institucione të ngjashme, përveç “Rilindjes”, nuk e zhvillojnë bashkëpunimin në bazë të kontratave të nënshkuara vjetore ose të ngjashme, por kohë pas kohe në bazë të marrëveshjeve të arritura të vetë institucioneve reciprokisht. Shkëmbimi i Shoqërive Kulturore Artistike (SHKA) ka filluar më 1970, kur në Kosovë ishte Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve Popullore nga RP e Shqipërisë. Prej kësaj kohe e këndeje, janë shkëmbyer nga një ose dy shoqëri të këtilla në vit, nga shoqëritë e RP-së së Shqipërisë për vizitë te ne. Përveç ansamblit të përmendur, kanë qenë edhe SHKA “A. Moisiu” nga Durrësi, SHKA nga Vlora dhe një nga Korça. Këto shoqëri nuk kanë ardhur drejtpërdrejt në Kosovë, por në mënyrë indirekte, nëpërmes RS-së së Maqedonisë, ku zakonisht kanë marrë pjesë në Ballkaniadat në Ohër, të cilat mbahen çdo vit. Nga shoqëritë tona, në RP-në e Shqipërisë kanë qenë “Shota” një herë, SHKA “E. Duraku” nga Zhuri dy herë, “Shote Galica” nga Gjakova dy herë, SHKA “Rugova” nga Rugova një herë. Disa prej këtyre shoqërive kanë dhënë shfaqje të suksesshme, gjersa të tjerat pak shumë kanë shkuar jo mjaft të përgatitura, mirëpo me kohë janë marrë masat përkatëse në vështrim të vizitave më kualitative dhe dhënies së shfaqjeve të shoqërive në RP-në e Shqipërisë. Gjithashtu, është bërë shkëmbimi i shfaqjeve teatrale: një herë në Prishtinë ka qenë Teatri Shtetëror Popullor nga Tirana, ndërsa nga ana jonë, shfaqjet në RP-në e Shqipërisë i ka dhënë Teatri Popullor Krahinor, një herë, dhe teatri gjysmë profesionist nga Gjakova. Gjithashtu Shoqata Krahinore e Shkrimtarëve gati rregullisht ka vizituar manifestimet e tyre të rëndësishme letrare, ndërsa nga RP e Shqipërisë janë dërguar disa shkrimtarë në festivalin e poezisë në Gjakovë te ne. Nga Gjakova, SHKA “Hajdar Dushi” dhe të tjerët gjithashtu, kanë qenë në RP-në e Shqipërisë. Viteve të para, pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, kanë filluar të zhvillohen edhe disa forma të bashkëpunimit në turizëm, vizitat e qytetarëve nga krahina jonë dhe me gjerë nëpërmes organizatave turistike. Tani ky bashkëpunim është reduktuar në vizitat selektive të qytetarëve tanë në RP-në e Shqipërisë, edhe atë nëpërmes ambasadës së tyre në Beograd. Është fjala për njerëz që kanë lidhje të ngushta familjare në RP-në e Shqipërisë, por edhe kjo formë është duke u bërë gjithnjë më selektive dhe më e vogël, gjë që tregon se Shqipëria nuk ka mundësi të lejojë zhvillimin më të gjerë të bashkëpunimit turistik e privat.

V

Me RP-në e Shqipërisë, manifestimeve kulturele i kushtohet kujdes i madh. Në të vërtetë, për ta, këto manifestime kanë rol të dyfishtë: a.) rolin mobilizues dhe b.) rolin afirmues. Duke pasur parasysh karakterin relativisht të mbyllur të shoqërisë shqiptare, në luftën e tyre të pandërprerë kundër të ashtuquajturve ndihma të huaja, në RP-në e Shqipërisë kjo formë e jetës po bëhet zëvendësim i një jete të llojllojshme kulturele dhe masat në këtë mënyrë po mobilizohen. RP e Shqipërisë bën shumë përpjekje, që t'i afirmojë vlerat vetjake kulturele, duke u munduar të mbajë autenticitetin dhe, më atë, të afirmohet në botë. Duke aplikuar mësimet e marksizëm-leninizmit, si pasojë e tyre, në kulturë bëhen përpjekjet që vlera tradicionale të inkorporohet në vlerat moderne por të vërteta kulturele, sepse modernizimi, nëse nuk është i bazuar në traditën autentike, thuhet në Shqipëri, po bëhet sterilitet e jo ndërrim kultural. Ata këtu shohin ndryshimin midis politikës kulturele dhe politikës së këtillë në vendet kapitaliste dhe “revizioniste” dhe këtu bazohen kritikata e tyre të ashpra kundër ndikimit të huaj. Mirëpo kultura tradicionale kurrë nuk mund të jetojë veç nga rrjedhat kryesore të jetës së civilizuar, prandaj RP e Shqipërisë dëshiron që në këtë pikëpamje të hapet, por në mënyrë selektive dhe graduale. Ajo nuk dëshiron t'i shtyjë vlerat e veta kulturele me vërshimet e kulturave tjera. Aq më tepër, ajo nuk dëshiron që vërshimi i këtillë të sjellë pasoja të çrregullimi i stabilitetit të jetës shoqërore-politike. Prandaj, në fillim i ka pranuar ato SHKA dhe shfaqja e të cilave nuk ka qenë në nivel të veçantë. Mirëpo, më vonë, ka bërë evolucione në qëndrimin e vet dhe ka shprehur gatishmërinë që t'i pranojë shoqëritë me një nivel më kualitativ. Mirëpo, këtu është paraqitur edhe një problem i cili ka të bëjë me zvarritjen rreth nënshkrimit të programit për bashkëpunim kulturor midis këtyre dy vendeve. Janë bërë përpjekje që ky bashkëpunim të zhvillohet në bazë të propozimeve të programit. Mirëpo, vetë kritika e marrëdhënieve me RP-në e Shqipërisë i ka tejkaluar disa këndime të propozimit të përmendur. Më të vërtetë, në planin shtetëror, me programin mbi bashkëpunimin kultural, zakonisht precizohen lëmët e bashkëpunimit midis dy vendeve gjatë një ose më shumë vjetëve. Kur programi i këtillë nënshkruhet, atëherë zakonisht, përkrahet realizimi i tij. Këtu, për disa kapituj, jepen edhe ndihma financiare dhe kryhen të gjitha përgatitjet e nevojshme. Programi i bashkëpunimit kultural me RP-në e Shqipërisë nuk është nënshkruar, por kjo, në të vërtetë, tregon nevojën që këtë bashkëpunim ta programojmë pa marrë parasysh në shtyrjen e nënshkrimit të programit të këtillë. Për programin e këtij bashkëpunimi, si dhe për politikën e bashkëpunimit kultural me botën e

jashtme në përgjithësi, duhet të forcohet Sekretariati për marrëdhëniet me botën e jashtme, si në pikëpamje kadrovike, ashtu edhe në materiale. Për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit me RP-në e Shqipërisë, në kuadër të Sekretariatit për marrëdhëniet me botën e jashtme, duhet të obligohen një se dy bashkëpunëtorë për përcjelljen e RP-së së Shqipërisë, duke pasur kujdes për faktin se Krahina nuk mund të jetë bartës i vetëm si dhe propozues i politikës sonë ndaj RP-së së Shqipërisë. Në të vërtetë, Krahina, në këtë pikëpamje, nuk mundet dhe nuk do të përpiqet të marrë përsipër rolin e Sekretariatit Federativ për punë të jashtme, i cili, sigurisht, duke pasur parasysh zhvillimin gjithnjë më intensiv të marrëdhënieve me RP-në e Shqipërisë, duhet ta forcojë shërbimin e vet për përcjelljen e RP-së së Shqipërisë. Sekretariati për marrëdhënie me botën e jashtme konsideron si sjellje mjaft negative të nikoqirit Qendrën krahinore kulture e propagandistike gjatë kohës së qëndrimit të SHKA “A. Moisiu” nga Durrësi në Krahinë, prej dt. 3 gjer 13 mars të vitit 1974. Kjo përvojë tregon se programi i qëndrimit të shoqërive të tjera eventuale në Kosovë nuk u duhet lënë organizatorëve që udhëheqin vetëm interesat financiare dhe njerëzve që janë të ngarkuar me paragjykimë. Përvoja ka treguar se shkëmbimi në planin e arsimit nuk ka dhënë rezultatet e arritura. Megjithëse në fillim ka qenë mjaft e zhvilluar forma e bashkëpunimit të njëanshëm, gradualisht, në zhvillimin e formave të tjera të bashkëpunimit, shkëmbimi në lëmin e arsimit është mjaft i reduktuar. Në të vërtetë, ka qenë fjala për vizitat masovike të personelit arsimor në RP-në e Shqipërisë për të fituar përvojë, për bashkëpunim në lëmin e arsimit etj. Me mbledhjen e zgjeruar të Sekretariatit të Komitetit krahinor të LKK-së, të mbajtur në tetor të vitit 1972, është ndërprerë rruga e stihisë në këtë shkëmbim. Jemi të mendimit që kjo formë e bashkëpunimit duhet sjellë në suazat reale dhe të lejohet vetëm në rastet kur është fjala për vizitën dhe bashkëpunimin arsimor-shkencor. Bashkëpunimi në planin e sportit është zhvilluar në mënyrë mjaft të paorganizuar. Kryesisht për arsye se degët e sporteve nuk kanë mundur të harmonizohen me marrëdhëniet reciproke, kështu që shpeshherë klubet kanë bërë gara se cili duhet të përfaqësojë këtë apo atë degë të sportit. Me iniciativën e KE-së, është penguar trendi negativ në këtë bashkëpunim, kështu që ai bëhet më tepër i organizuar. Ajo që është e përbashkët për këto forma të bashkëpunimit, është domosdoshmëria që cilado formë e bashkëpunimit me RP-në e Shqipërisë të zhvillohet në mënyrë të organizuar dhe jo spontanisht, ose në mënyrë stihike dhe jo vetëm me RP-në e Shqipërisë, por edhe më gjerë.

VI

Në zhvillimin e përgjithshëm të këtyre marrëdhënieve me RP-në e Shqipërisë, akoma ekziston një seri dobësish, që në pjesën më të madhe paraqiten për shkak të mosorganizimit tonë vetjak, për arsye se nuk kuptohet plotësisht ndërlíkueshmëria e marrëdhënieve midis RSFJ-së dhe RP-së së Shqipërisë dhe defnítivisht, për arsye se në vend dhe jashtë vendit ekzistojnë shumë fuqi nga të gjitha nacionalitetet që janë kundër politikës së LKJ-së dhe LK-së së Kosovës për zhvillimin e politikës së paangazhimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve të mira të shtetit tonë me shtetet fqinje. Këtyre forcave nuk u shkon në llogari forcimi i rolit të LKJ-së, forcimi i rolit dhe pozitës së Jugosllavisë në botë dhe i politikës së saj të mosangazhimit, si dhe politikës së marrëdhënieve të mira me shtetet fqinje. Për këtë dhe për arsyt e tjera, duhet të forcohet aktiviteti në planin e aftësisimit të shërbimeve që i përcjellin këto marrëdhënie, koordinimin dhe informimin reciprok, si brenda në Krahinë, ashtu edhe në vijën Krahina-organet federative dhe shërbimet, si dhe në planin e aftësisimit të të gjitha subjekteve-bartësve të punëve konkrete në marrëdhëniet me RP-në e Shqipërisë dhe më gjerë. Kjo, pa mëdyshje, do të kontribuojë jo vetëm në zvogëlimin e dukurive të panevojshme negative, por do të paraqesë pasqyrën adekuate të shoqërisë sonë në tërësi.

VII

Marrëdhëniet midis RSF-së së Jugosllavisë dhe RP-së së Shqipërisë, viteve të fundit po shënohen me trendin pozitiv të ecurive, si në planin ekonomik, ashtu edhe në planin shkencor-arsimor dhe kultural. Deklaratat e paradokohshme të udhëheqësve politikë të të dy vendeve, hapin mundësi dhe japin shanse të reja për zgjerimin e bashkëpunimit me pika me interes për të dy vendet dhe në parimet e respektimit reciprok të integritetit territorial të sovranitetit dhe të barazisë nacionale e të mos përzierjes me punët e brendshme. Në LK dhe në organizatat e tjera shoqëroro-politike të bëhet më intensiv aktiviteti ideo-politik me interpretimin dhe në kuptimin esencial të disa momenteve, në bashkëpunim jugosllavo-shqiptar, me analizimin real të këtyre marrëdhënieve dhe të mundësive reale të bashkëpunimit si dhe më organizimin, vigjilencën dhe me përgjegjësinë që kemi ne në Kosovë, në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të vendit tonë me RP-në e Shqipërisë. Në planin politik, ashtu si në planin shkencor, arsimor e kultural, është e domosdoshme që të vazhdojnë përpjekjet e punës së organizuar me këtë bashkëpunim. Në këtë vështrim, Kryesia përkrah përpjekjet e forcimit kadrovik dhe material të Sekretariatit të marrëdhënieve me botën e jashtme.

Propozohet që në këtë vështrim, për vëllimin e rritur të bashkëpunimit me RP-në e Shqipërisë dhe bazën e perspektivës në këtë bashkëpunim, të merren masat përkatëse dhe në nivel federativ për forcimin e shërbimit në kuadër të SFPJ-së, për përcjelljen e këtyre qëllimeve RP-së së Shqipërisë dhe të ambasadës së RSFJ-së në Tiranë. Përpjekjet në drejtim të koordinimit të punës me organet federative, duhet të vazhdojnë gjithnjë e më tepër. Për zgjerimin dhe përfshirjen më efektive të Krabinës sonë në këtë bashkëpunim, në planin ekonomik, është e domosdoshme që, në mënyrë më konkrete dhe me afate, të fillojë realizimi i obligimeve të përcaktuara, që të mos injorohen as kërkesat më të vogla dhe të mos bëhen shantazhe dhe nënçmime, si dhe kushtëzime. Prandaj, është e domosdoshme që organizatat punuese përkatëse dhe organet kompetente t'i shqyrtojnë mundësitë e zgjerimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me RP-në e Shqipërisë në planin e lidhjes në komunikacionin automobilistik dhe ajror, dhe duke marrë parasysh se po përdoret rruga Prizren-Kuliç me ndërtimin e hidrocentralit "Fierzë"; në planin e përmirësimit të lidhjeve PTT, mbasi lidhjet e tashme nëpërmjet Beogradit zhvillohen me mjaft vështirësi dhe pengesa; në planin e angazhimit më të madh të "Eximakosit" në punët e tregtisë së jashtme me RP-në e Shqipërisë, përfaqësimit më të madh të KSA-së së Kosovës me kuadro ekonomike në RP-në e Shqipërisë dhe të përmirësimit të strukturës së vëllimit të qarkullimit të mallit dhe të formave të tjera të bashkëpunimit me RP-në e Shqipërisë.

Në mungesë të programit të bashkëpunimit kultural, duhet të bëhen përpjekje në drejtim të orientimit dhe të programimit të bashkëpunimit arsimor-kultural të KSA-së së Kosovës në RP-në e Shqipërisë".⁷

Marrëdhëniet midis RFS-së së Jugosllavisë dhe të RP-së së Shqipërisë

– Pozita e KSA-së së Kosovës dhe detyrat e saj –
– Tezat kryesore –

“Propozim masat:

1. Në kontekst të forcimit të prezencës së Krabinës në planin ekonomik, duhet të insistohet që të mënjanohen këta faktorë pengues:

- a. të dërgohet një delegacion ekonomik i KSA-së së Kosovës në RP-në e Shqipërisë, i cili do t'i hulumtonte mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në lëmin e këmbimit të mallrave;
- b. të përpunohet propozimi për përmirësimin e lidhjeve (rrugëve,

⁷ AK, F. SKMBJ, V. 1979-1988, K. 3, Nr. i lëndës 36.

hekurudhave, linjave ajrore) të komunikacionit me RP-në e Shqipërisë;

- c. të hulumtohen mundësitë për bashkëpunimin e planifikimin hapësinor;
- d. të dërgohet një shok nga KSA e Kosovës (punohet në këtë drejtim) pranë ambasadës së RSFJ-së në Tiranë, ose në cilësinë e përfaqësuesit të Dhomës;
- e. duhet që organizatave ekonomike t'u tërhiqet vëmendja për nevojën që të jenë uajjal në bashkëpunimin me RP-në e Shqipërisë, t'u përmbahen rregullave të tyre për mënyrën e kontaktit me të huajt dhe t'i respektojnë afatet e përcaktuara për dërgimin e mallit.

2. Në planin politik, duhet mbajtur llogari për disa çështje të rëndësishme. Në fakt, nuk mund të kërkohet hapja e shpejtë e kufijve dhe, në këtë drejtim, nuk është e nevojshme të bëhet presion.

Mirëpo, gjatë dërgimit të delegacioneve, ato duhet të përgatiten si në planin ideologjik, ashtu edhe në atë procedural. Sekretariatit për marrëdhënie me jashtë duhet t'i mundësohet ta kryejë detyrën e informimit dhe përgatitjes së delegacioneve. Në këtë drejtim, është me rëndësi të dihet caku i shkuarjes eventuale të delegacionit, karakteri i manifestimit në të cilin ato marrin pjesë dhe nivelit të atyre delegacioneve. Sekretariati për marrëdhënie me jashtë nuk mund t'i zgjedhë ato delegacione, por nuk mund të lejojë që të mos konsultohen në lidhje me vizitat e tyre. Për shkak të mosinformimit të këtij sekretariati, ambasada e RSFJ-së në Tiranë, mbetet jashtë ngjarjeve që ndodhin, ndërkaq, nga ana tjetër, për shkak të përgatitjeve joadekuate të disa delegacioneve, shkaktojmë habi te vetë anëtarët e delegacioneve, të cilët nganjëherë mendojnë se përfaqësojnë RSFJ-në ose KSA-në e Kosovës e jo institucionet e tyre. Kësaj i kontribuon edhe fakti se në shtypin e RP-së së Shqipërisë rregullisht shkruhet për qëndrimin e delegacioneve tona në këtë vend. Nga ana tjetër, shtypi ynë, të cilit askush asgjë nuk i tregon, plotësisht është i heshtur.

3. Në bashkëpunimin arsimor – shkencor duhet që sa më parë t'i qasemi precizimit të kompetencave në këtë problematikë.

Në fakt, "Rilindja" – edicioni i botimeve të librave dhe Enti krahinor i mjeteve arsimore, duhet të merret vesh se kush nga ata është kompetent për blerjen e librave dhe mjeteve të tjera shkollore.

4. Pritet të zgjidhet çështja e formimit të komisionit apo trupave për dhëniën e lejes për të huajt, që do të bëjnë hulumtime shkencore te ne.

Në mbledhjen e fundit të Entit Federativ (18. II. 1974) u arrit ujdia që t'i propozohet KEF-së (Këshilli Ekzekutiv Federativ), që çështja e këtyre

komisioneve të zgjidhet me anë të kritereve më të thjeshta në tërë Jugosllavinë dhe kjo, me siguri, do të ndodhë. Prandaj, duhet të pritet që një komision i karakterit shkencor shtetëror ta bëjë zgjedhjen e disa kërkesave për punë shkencore – hulumtuese, aftësim, specializim dhe përgatitjen e disertacioneve të magistraturës dhe doktoraturës në RP-në e Shqipërisë. Sekretariati për marrëdhënie me jashtë tashmë ka përgatitur projekt – propozim për një kërkesë të tillë, realizimi i të cilit pritet paralelisht me rezultatet rreth sjelljes së vendimit të KEF-së, që, sipas mendimit tonë, do ta zgjidhë çështjen e sipërtheksuar për bashkëpunimin e Krahinës në lëmin e specializimit në vendet e jashtme.

5. Përvojat e kohëve të fundit, sidomos gjatë këtij viti, tregojnë se disa kuvende komunale, kanë filluar të konsiderojnë se nuk duhet të informohen organet Krahinore për shkuarjen e disa grupeve në RP-në e Shqipërisë ose diku tjetër.

Sekretariati konsideron se LKK-ja duhet të insistojë te këto komuna, që të respektohen vendimet e sekretariatit të LK KSA-së, nga viti 1972.

6. Sipas vlerësimeve tona, nuk ka mundësi të zhvillimit të karakterit spektakolar të marrëdhënieve me RP-në e Shqipërisë, pos marrëdhënieve të karakterit të organizuar. Prandaj, pavarësisht faktit se akoma nuk është nënshkruar programi i bashkëpunimit kulturor, duhet të mblidhen propozimet për bashkëpunim, për vitin 1975, nga të gjitha institucionet kulturore dhe të përpilohet programi i brendshëm për bashkëpunim. Një propozim-program të tillë, bashkërisht do ta shqyrtonin kryetari i komisioneve për marrëdhënie me jashtë në Krahinë dhe i Sekretariatit krahinor për arsim, shkencë e kulturë. Njësoj duhet të veprohet edhe në pikëpamjen e bashkëpunimit sportiv me RP-në e Shqipërisë si dhe të shqyrtohen mundësitë e zhvillimit të disa formave elementare të mbajtjes së garave ndërkufitare sportive. Mirëpo, kjo duhet të verifikohet përmes rrugës diplomatike dhe jo përmes organizatave sportive.

7. Duhet të shmangen marrëveshjet individuale rreth shkuarjes në RP-në e Shqipërisë dhe të vihet në pah nevoja e konsultimit me organet dhe institucionet përkatëse.

8. Më në fund, është koha të mendohet për dërgimin, ose të ftohet një delegacion politik, i cili konkretisht do të konstatojë se çfarë mund të bëhet më tutje. Delegacioni do të shkonte në marrëveshje me Sekretariatit Federativ për Marrëdhënie me Jashtë dhe, pas kthimit të delegacionit, do të mund të saktësohen mënyrat e realizimit të bashkëpunimit kulturor me RP-në e Shqipërisë”.⁸

TEPER REZERVAT

ODNOSI IZMEĐU SFR JUGOSLAVIJE I NR ALBANIJE - POLOŽAJ SAP
KOSOVA I NJENI ZADACI
- Glavne teze -

Krahina Socialiste Autonome e Kosoves
KESHILLI EKZEKUTIV I KUVENDIT TE KSAK

SEKRETARIATI PER HARRDHEHIS ME

Teper Rezervat

KOPEN E JASHTINE

OL Numer: 27-54/74

Prishtine, 20.XI.1974

Bashkangjitur me aktin po u dorezojme materialin mbi
marredhenjet me RP te Shqiperise, te dsdikuar Kryesise se Krahines, me
lutje qe t'i jipni sugjerimet dhe verejtjet tuaja paraprake, ne frymen
e marreveshjes se perbashket mbi pergaditjen e ketij materiali.

Per shkak te urgjences se shqyrtimit te tij nga ana e
Kryesise luteni qe te gjeni kohe per konsultim te perbashket gjate di-
tes se neserme, ne kohen qe do t'a caktoni ju vet.



SEKRETARI,

Ukshin Hoti

Predlog mera:

1. U pogledu jačanja prisustva Pokrajine na ekonomskom planu treba da se insistira da se otklone sledeći limitirajući faktori:

a/ da se uputi jedna privredna delegacija iz SPP Kosova u NR Albaniji koja bi istražila mogućnosti proširivanja saradnje iz oblasti robne razmene;

b/ da se ovde, najpre, razradi predlog za poboljšanje unutrašnjih (putevi, željeznice, avionska linija) i komunikacionih veza (PTT) sa NR Albanijom;

c/ Introdovati mogućnost saradnje na prostornom planiranju;

d/ da se uputi jedan drug iz SPP Kosova (ovo se već rešava) pri Ambasadi SPPJ u Tirani ili u svojstvu predstavnika Komore;

e/ Treba da se privrednim organizacijama okrene pažnja na potrebu da se lojalno ponašaju u saradnji sa NR Albanijom; da se pridržavaju svojih pravilnica o sačinu kontaktiranja sa strancima i da se poštuju utvrdjeni rokovi isporuka robe.

2. Na političkom planu, treba voditi računa u izvoznim stvarima. Naime, ne sme se zahtevati naglo otvaranje granica, niti bi bilo korisno da se vrši pritisak u tom pravcu. Najbolje, prilikom upućivanja pojedinačne delegacije, one se moraju pripremiti i to, kako idololudno,



tako i proceduralno. Treba omogućiti Sekretarijatu za odnose sa inostranstvom da obavlja funkciju informisanosti i pripreme delegacije. Naime, u tome je važno da se zna cilj odlaska eventualne delegacije; da se karakter manifestacije ko- me ona prisustvuje i nivo koji se takvoj delegaciji želi dati. Sekretarijat za odnose sa inostranstvom ne može da bira takve delegacije, ali ne može dozvoliti da se ne konsultuje u vezi njihovog odlaska. Zbog neinformisanja ovog Sekretarijata, onda i Ambasada SFRJ u Tirani, ostaje potpuno van događaja, dok s druge strane, zbog neadekvatne pripreme pojedinih delegacija unosimo zbatjenost kod samih članova delegacije koji ponekada pomišljaju da predstavljaju SFRJ, ili SFRJ Kosovo, a ne vlastitu instituciju. Tome doprinosi i činjenica da se u NR Albaniji redovno javlja u štampi o prisustvovanju pojedinih naših delegacija, dok istovremena naša štampa, koju niko ne upućuje, potpuno šuti.

Kod prosvetno-naučne saradnje treba što pre da se pristupi preciziranju nadležnosti iz ove problematike. Naime, "Rilindija"- i to Komisija za izdavanje knjiga i Pokrajinski Zavod za izdavanje nastavnih sredstava i učila treba da se sporazume oko toga koji od njih dve nadležan za kupovinu i nabavku udžbenika, školskih učila i sredstava.

4.

Na putu je rešavanje pitanja formiranja komisije ili tela za izdavanje odobrenja strancima za izvođenje naučno-istraživačkih radova kod nas. Na poslednjem se sastanku u Saveznom Zavodu



(od 18.II.74.g.) se stalo na stanovište da se predloži JIV-u, da se pitanje ovih komisija reši po jedinstvenom kriterijumu u čitavoj Jugoslaviji, što će se verovatno i na taj način uraditi. Prema tome, treba očekivati da će jedna komisija naučno-dravnog karaktera presuci pitanje rešavanja pojedinih naučeva sa odlaskom na naučno-istraživački rad, usavršavanje, specializacije i pripremanje magistrskih i doktorskih disertacija u NR Albaniji. Sekretarijat za odnose sa inostranstvom, već je izradio nacrt jednog takvog predloga čije se rešavanje odlaže paralelno sa rezultatima obo razmatranja odluke JIV-a, a koje bi po našem mišljenju rešilo pomenuto pitanje za ovu saradnju Pokrajine iz oblasti specializacija u inostranstvo.

5. Končno, iskustvo u poslednje vreme, naročito u toku ove godine, pokazuje da su neke Opštinske Učupštine, ~~na primjer~~, Kosovska-literarica, Djakovica i Peđe, počele smatrati da ne treba informisati više Pokrajinske organe za odlazak nekih grupa u NR Albaniju ili drugde. Sekretarijat smatra da SKK treba insistirati kod ovih opština da se poštuju odluke Sekretarijata PK SKK od novembra 1972. godine;
6. Po našem ocenama, novo mogućnosti razvijanja odnosa spektakularnog karaktera sa NR Albanijom, već odnosa organizovanog karaktera. Ulag toga, bez obzira na činjenicu što još uvijek nije potpisan Program kulturne saradnje, treba da se sakupi predlozi za saradnju



1975. godinu iz svih kulturnih institucija i načini unutrašnji program saradnje. Takav predlog programa bi razmatrali zajedno Predsednici Komisija za odnose sa inostranstvom u Pekarijski, Sekretarijat za odnose sa inostranstvom i Pekarijski sekretarijat za obrazovanje, nauku i kulturu.

- Treba isto uraditi i u pogledu sporta saradnje sa NR Albanijom, kao i da se sagledaju mogućnosti razvijanja nekih elementarnih oblika ohrabivanja sportskih popranioničkih takmičenja. Nadjućin, ova stvar da se ispita diplomatskim putem, a ne preko sportskih organizacija.

9. Potrebno je izbegavati pojedinaćna dogovore oko odluka u NR Albaniji i podvlaćiti potrebu konsultovanja postojećih organa i institucija.

8. Najzad, vreme je da se pomislija na nlanjanje ^{u istom} jedne politické delegacije koja bi konkrećno ustanovila šta je od svega toga moguće uraditi. Delegacija bi išla u dogovor sa MIP-om i drugim svezasne organizacijama, a nakon njunog povratka, taćno bi ustanovila puteve i načine ostvarivanja kulturne saradnje sa NR Albanijom.

17

14

KUVENDI I KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS
SEKRETARIATI PËR MARRËDHËNIE ME BOTËN E JASHTME

TEP.REZERVAT

- Vetëm për përdorim
personal



MARRËDHËNIET MIDIS RSH TË JUGOSLLAVISË
DHE TË RP TË SHQIPËRISË

- Pozita e KSA të Kosovës dhe detyrat e saj